



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 korrik 2024
Nr. Ref.: RK 2479/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI293/23

Parashtrues

Musa Shabani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit E. Rev. nr. 17/23
të Gjykatës Supreme, të 5 tetorit 2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Musa Shabani, me vendbanim në Komunën e Mitrovicës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Safet Voca, avokat në Komunën e Mitrovicës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [E. Rev. nr. 17/2023] të 5 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktvendimin [K. DH. SH. II. nr. 269/22] e 7 marsit 2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kërkon edhe vendosjen e masës së përkohshme për të ndaluar procedurën përmbarimore të lejuar sipas Urdhrit përmbarimor [P. Nr. 773/2023] të 23 nëntorit 2023, me arsyetimin se atij do t'i shkaktohet dëm i riparueshëm për faktin se nuk ka pronë tjetër për banim, se është i moshuar dhe ka gjendje jo të mirë shëndetësore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masa e përkohshme) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe të rregullit 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 dhjetor 2023, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të cilën e kishte dorëzuar në postë më 22 dhjetor 2023.
7. Më 16 janar 2024, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR. KI293/23] caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese ndërkaq përmes Vendimit [Nr. KSH.KI293/23] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 24 janar 2024, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

10. Më 26 qershor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 20 mars 2023, Gjykata Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes Aktvendimit [E. nr. 36/2011] kishte lejuar përmbarrimin sipas Aktgjykimit [C. nr. 147/2006] të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, me të cilin parashtruesi i kërkesës ishte detyruar që në emër të përmbushjes së borxhit nga kontrata mbi kredinë t'i paguante paditëses Banka e Re e Kosovës, shumë prej 180.973,80 euro, me kamatën në lartësi mujore prej 1.3%. Ndërkaq, më 18 prill 2013, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [E. nr. 36/2011], refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore. Më 14 maj 2014, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktvendimit [CA. nr. 1369/2013] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [E. nr. 36/2011] e 18 prillit 2013.
12. Më tej, nga shkresat e rastit rezulton se, më 13 janar 2016, Zyra e Përmbarruesit Privat A.M., kishte pranuar lëndën [E. nr. 36/2011] nga Gjykata Themelore, sipas kërkesës së kreditorit, "NLB Banka" SH.A., për transferimin e lëndës tek përmbarruesi. Gjatë procedurës tek përmbarruesi privat ishin mbajtur dy ankande publike, ku në ankandin e dytë borxhi që debitori kishte ndaj kreditorit ishte precizuar në shumë prej 165.000 euro dhe kreditori kishte ofertuar shumë prej 54.300,00 euro për blerjen e pronës së debitorit.
13. Më 30 korrik 2021, përmes Urdhrit [P. nr. 09/16], Përmbarruesi Privat (i) caktoi blerës "NLB Banka" Prishtinë SH.A., që kishte ofertuar 54.300,00 euro, sipas Aktvendimit për regjistrimin e Hipotekës të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, nr. 198/2003, të 19 nëntorit 2003, si gjykatë e intabulacionit, për ngastrat kadastrale P-71208072-03002-9 dhe P-71208072-03003-7; (ii) urdhëroi parashtruesin e kërkesës që paluajtshmërinë t'ia dorëzojë kreditorit brenda shtatë (7) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së Urdhrit; (iii) urdhëroi Drejtorinë për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër që paluajtshmërinë ta regjistrojë në emër të kreditorit; si dhe (iv) konstatoi se pas blerjes së patundshmërisë, shumë e mbetur nga borxhi prej 165.000 euro, kreditori mund ta realizonte me mjete të tjera përmbarrimore nga pasuria e debitorit.
14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në Gjykatën Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, kundër Urdhrit për shitje [P. nr. 09/16] të Përmbarruesit Privat, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarrimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
15. Më 7 mars 2023, Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit [K. DH. SH. II. nr. 269/22], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Urdhrin për shitje të nxjerrë nga Përmbarruesi Privat. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë vlerësoi se Urdhri për shitje ishte i rregullt dhe i ligjshëm, nuk ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës përmbarrimore dhe kontestimore dhe se drejtë ishte vërtetuar gjendja faktike dhe zbatuar e drejta materiale.

16. Më 17 mars 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi propozim për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, kundër Aktvendimit të lartpërmendur.
17. Më 22 mars 2023, Zyra e Prokurorit të Shtetit përmes Njoftimit [KMLC. nr. 32/2023] e njoftoi parashtruesin e kërkesës se mbështetur në paragrafin 3 të nenit 14 të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale (GZ. numër 7, 10 shkurt 2022) (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjykatën Komerciale), kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e lejuar.
18. Më 28 mars 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit [K. DH. SH. II. nr. 269/22] të 7 marsit 2023 të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes së cilit ishte vërtetuar Urdhri për shitje i 30 korrikut 2021 i nxjerrë nga Përmbartuesi Privat, ku blerës ishte caktuar “NLB Banka” Prishtinë SH.A. Përmes revizionit, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe shkelje të nenit 31 të Kushtetutës.
19. Më 9 qershor 2023, “NLB Banka” Prishtinë SH.A. dorëzoi përgjigje ndaj revizionit të parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës kërkoi që Gjykata Supreme të hedhë poshtë revizionin, pasi që nuk është i lejuar sipas Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (GZ. numër 3, 31 janar 2013) (në tekstin e mëtejme: Ligji për Procedurën Përmbartimore).
20. Më 5 tetor 2023, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [E. Rev. nr. 17/2023] hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se revizioni nuk është i lejuar në procedurë përmbartimore sipas paragrafit 1 të nenit 68 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.
21. Nga shkresat e rastit rezulton se më 23 nëntor 2023, përmes Urdhrit Përmbartimor [P. nr. 773/2023], Përmbartuesi Privat B.T., lejoi përmbartimin e propozuar nga kreditori për lirin e ngastrave kadastrale nga njerëzit dhe sendet dhe se, kundër tij, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur prapësim pranë Gjykatës Komerciale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt të KEDNJ- së.
23. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë ka dështuar që drejtë të vlerësojë faktin se dispozitivi i Urdhrit Përmbartimor [P.nr. 09/2016] është në kundërshtim me arsyetimin e tij, se nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare dhe se nuk janë vlerësuar provat veç e veç dhe së bashku. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se Përmbartuesi Privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbartimore pasi që ka skaduar afati kohor brenda së cilës mund të kërkohet përmbartimi. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës shton se Aktvendimi për Regjistrimin e Hipotekës nr. 198/2003 i Gjykatës Komunale në Mitrovicë nuk kishte cilësinë e dokumentit përmbartimor.

24. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se përmes Aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, nuk ishte vlerësuar drejtë fakti se në procedurën para gjykatës si dhe para Përmbartuesit Privat, kreditori nuk ishte përfaqësuar nga persona të autorizuar sipas ligjit.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, pasi që atij dhe bashkëshortes së tij, bashkëpronare në paluajtshmëri, nuk u ishte mundësuar që çështja e tyre të degjohej drejtë, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm kohor si dhe nuk u ishte mundësuar mbrojtja e barabartë e të drejtave në procedurë përmbartimore.
26. Parashtruesi i kërkesës po ashtu shton se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është jologjor pasi që sipas tij është nxjerrë në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 14 të Ligjit për Gjykatën Komerciale dhe se Gjykata Supreme gabimisht ka zbatuar paragrafin 1 të nenit 68 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon që: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [E. Rev nr. 17/2023] e 5 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme; (iv) të caktojë masën e përkohshme me të cilën e ndalon përmbartimin e Urdhrit Përmbartimor [P. nr. 773/2023] të 23 nëntorit 2023, deri në marrjen e mendimit nga Gjykata Supreme në rishqyrtim; dhe (v) të kthejë në rishqyrtim Aktvendimin [E. Rev nr. 17/2023] e Gjykatës Supreme dhe ta obligojë atë që të nxjerrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale), nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

31. Gjykata më tej i referohet edhe rregullit 29 (Llogaritja e periudhës kohore) dhe rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës:

Rregulli 29
(Llogaritja e periudhës kohore)

Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore, llogaritet si më poshtë:

[...]

(d) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore.

[...]

(g) përjashtimisht, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit ; dhe

32. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [E. Rev. nr. 17/2023] e 5 tetorit 2023 të Gjykatës Supreme, pasi ka shteruar mjetet juridike të parapara me ligj.
33. Në vlerësimin nëse janë përmbushur kriteret e nenit 49 të Ligjit në lidhje me rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse kriteri për afatin katër (4) mujor, i përcaktuar me Ligj është respektuar në raport me “vendimin përfundimtar”, të nxjerrë si rezultat i “mjetit juridik efektiv”, siç kërkohet me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Rregullore të punës.
34. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesi duhet t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesi nuk mund të zgjasë afatet kohore të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të ushtrojë mjete juridike që nuk janë të lejuara ose duke u ankuar në institucionet të cilat nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih, rastet e Gjykatës [KIo6/23](#), parashtrues *Hizri Haxhiu*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2024, paragrafi 20; [Kl112/19](#), parashtrues *Illir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 38; si dhe rastin e GJEDNJ-se, [Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 14881/04, Vendim i 5 janarit 2006).
35. Gjykata vëren se më 17 mars 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi propozim për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, kundër Aktvendimit [K. DH. SH. II. nr. 269/22] të Gjykatës Komerciale, kërkesë e cila u refuzua si e palejuar përmes Njoftimit [KMLC. nr. 32/2023]. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk e konteston Njoftimin e lartcekur të Zyrës së Prokurorit të Shtetit para Gjykatës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të vlerësojë nëse vendimi që kontestohet, përkatësisht Aktvendimi [E. Rev nr. 17/2023] i 5 tetorit 2023 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë si rezultat i mjetit juridik efektiv, respektivisht, nëse revizioni i ushtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit [K. DH. SH. II. nr. 269/22] të 7 marsit 2023 të Gjykatës Komerciale- Dhoma e Shkallës së Dytë ishte mjet juridik efektiv, i përcaktuar me ligj.
37. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme me Aktvendimin [E. Rev nr. 17/2023] e 5 tetorit 2023, hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë duke arsyetuar: “Me nenin 68, paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se: “nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurë përmbartimore” dhe duke marrë parasysh faktin se revizioni është ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K. DH. SH. II. nr. 269/22, të datës 07.03.2023, i cili vendim është marrë në procedurën e përmbartimit, revizioni është i palejuar, për çka revizioni i debitorit është dashur të hedhet poshtë”.
38. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 68 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i cili përcakton:

1.“Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbartimore”.
[...]

39. Gjykata vëren që në rastin e parashtruesit të kërkesës, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, asgjë nuk e ka penguar parashtruesin e kërkesës për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ai përdori mjete juridike, përkatësisht revizionin, i cili nuk ishte parashikuar me ligj.
40. Rrjedhimisht, si “vendim i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit është Aktvendimi [K. DH. SH. II. nr. 269/22] i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, me të cilin ishte refuzuar si e pathemeltë ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Urdhrit për shitje [P. nr. 09/16] të Përmbauesit Privat (shih, rastin e Gjykatës [KI240/19](#), parashtrues *Enver Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafi 49).
41. Gjykata rikujton se Aktvendimi [K. DH. SH. II. nr. 269/22] i Gjykatës Komerciale ishte nxjerrë më 7 mars 2023. Edhe pse parashtruesi nuk ka cekur datën e pranimit të këtij vendimi, nga faktet e rastit, është e qartë se koha në mes të pranimit të aktvendimit të lartcekur dhe datës së dorëzimit të kërkesës së tij, më 22 dhjetor 2023, në Gjykatë, ka kaluar periudhën kohore prej 4 (katër) muajsh (shih, rastin e Gjykatës [KI112/19](#), parashtrues *Ilir Kabashi*, cituar më lart, paragrafi 44).
42. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit në lidhje me Aktvendimin [K. DH. SH. II. nr. 269/22] e Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
43. Më tej, Gjykata rikujton se rregulli i afatit katër-mujor është autonom dhe duhet kuptuar dhe aplikuar bazuar në faktet e secilit rast veç e veç për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për të paraqitur kërkesën para Gjykatës. Gjykata thekson se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe pikën (c) të paragrafit 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës, i shërben sigurisë juridike dhe siguron që çështjet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe parandalon autoritetet dhe personat e tjerë të afektuar që të mos mbahen në një gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë (shih, rastin e GJEDNJ-së *Lekic kundër Sllovenisë*, nr. 36480/07, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi 65). Ky rregull gjithashtu i jep kohë parashtruesit potencial nëse do të paraqes një kërkesë në Gjykatë, dhe, nëse po, të vendosë për argumentet specifike që do i paraqes si dhe rrjedhën e fakteve, pasi që me kalimin e kohës bëhet i vështirë shqyrtimi i çështjeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës (shih, rastin e GEDNJ-së, *Sabri Güneş kundër Turqisë*, nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 52 dhe 55).
44. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe pikën (c) të paragrafit 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes Aktgjykimit të kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

45. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon vendosjen e masës së përkohshme nga Gjykata me arsyetimin se si rezultat i përmbaimit atij do t'i shkaktohet dëm i pariparueshëm për faktin se nuk ka pronë tjetër për banim, se është i moshuar dhe ka gjendje jo të mirë shëndetësore.

46. Gjykata më sipër ka konstatuar se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe me rregullin 45 (Vendimmarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të neneve 27 dhe 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (1) (c) dhe 45 të Rregullores së punës, më 26 qershor 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË REFUZOJË, kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- V. TË KONSTATOJË që ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani